



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:213822
Datë: 29.08.2024
Numri i dokumentit: 06101753

C.nr. 2317/22

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, me gjyqtarin Migjen Kastrati, në çështjen juridike kontestimore të palës paditëse, Sh.G nga fshati O, Komuna e Pejës, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shaban Gashi, avokat në Pejë, kundër të paditurit Z.G nga fshati O, Komuna e Pejës, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Armend Gashi nga Peja, me objekt kontesti, vërtetimi i pronësisë, me vlerë të kontestit 4,000.00 €, duke vendosur lidhur me lejueshmërinë e marrëveshjes së lidhur në mes të palëve ndërgjyqjese në procedurën e ndërmjetësimit, jashtë seancës me datën, 29.08.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET MARRËVESHJA JASHTËGJYQËSORE me numër Nd.nr. 421/24 e arritur në Qendrën për Ndërmjetësim në Pejë me datën 08.05.2024, e lidhur në mes të palës paditëse, Sh.G nga fshati O, Komuna e Pejës, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shaban Gashi, avokat në Pejë, kundër të paditurit Z.G nga fshati O, Komuna e Pejës, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Armend Gashi nga Peja, , me objekt kontesti, vërtetimi i pronësisë, me vlerë të kontestit 4,000.00€.

II. Pjesë përbërëse e këtij aktvendimi është marrëveshja e ndërmjetësimit Nd.nr. 421/24 e datës 08.05.2024 e cila e ka fuqinë e titullit ekzekutiv.

A r s y e t i m

Paditësi përmes të autorizuarit të tij, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi me datën 18.10.2022, kundër të paditurit, me objekt kontesti, për vërtetimin e të drejtës së pronësisë, me vlerë të kontestit, 4,000.00€.

Në Qendrën e Ndërmjetësimit kjo lëndë është referuar me datën 08.05.2024 dhe palët ndërgjyqëse me datën 18.05.2024, respektivisht të autorizuarit e tyre, kanë arritur marrëveshjen për këtë çështje juridiko civile dhe gjykatës i është dorëzuar marrëveshja e arritur në mes palëve ndërgjyqëse, respektivisht të autorizuarve të tyre.

Gjykata me rastin e shqyrtimit të marrëveshjes se ndërmjetësimit me nr. të referencës Nd.nr. 421/24 të datës 08.05.2024 e lidhur në Qendrën për Ndërmjetësim në Gjykatën Themelore në Pejë, në mes të autorizuarve të palës paditëse dhe të paditurit, me objekt kontesti, vërtetimin e të drejtës së pronësisë (për më tepër sikurse në marrëveshjen e datës 08.05.2024, pjesë e shkresave të lëndës), vlerëson se kjo marrëveshje i plotëson kushtet ligjore, pasi që kjo gjykatë ka konstatuar se e njëjta nuk është lidhur në kundërshtim me ligjin dhe për këtë arsye bazuar edhe në dispozitat ligjore të nenit 3.3, nenit 411 dhe 412 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, lidhur me nenin 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 10, 11, 12, 14 dhe 15 par. 1 të Ligjit për Ndërmjetësimin me nr. 06/L-009, erdhi në përfundim se marrëveshja jashtëgjyqësore duhet të miratohet dhe si e tillë e njëjta e ka fuqinë e titullit përmbarues.

Nga të lartcekurat, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2022:213822, C.nr.2317/22, datë 29.08.2024

G j y q t a r i
Migjen Kastrati

UDHËZIM JURIDIK:

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.